



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1 Tiranë;

E-mail: klsh@klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 360/6 Prot.

Tiranë, më 20/08/2019

V E N D I M

Nr. 51, Datë 20.08.2019

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUTIN E STUDIMEVE TË KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT "MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË"
për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 30.05.2019.

Nga auditimi i ushtruar në "Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit" (ISKPK) me objekt "Auditim përputhshmërie" për periudhën 01.01.2018 deri më datë 30.05.2019, mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së ISKPK^{së} me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të ISKPK^{së}, rezultoi se:

- *ISKPK për periudhën objekt auditimi ka përmbytur me sukses misionin dhe qëllimin e punës në lidhje me grumbullimin, studimin, analizimin, evidentimin e fakteve dhe informimin e publikut;*
- *ka menaxhuar drejt veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit;*
- *ka administruar përgjithësisht drejt, vlerat materiale dhe monetare të vëna në dispozicion, bazuar në rregullat buxhetore;*
- *raportimet financiare paraqesin drejt veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit dhe i kanë dhënë menaxherit të lartë gjithë informacionin e nevojshëm për menaxhimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit; - menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm përgjithësisht kanë funksionuar drejt, por në veçanti evidentohet nevoja për përmirësime, kryesisht në drejtim të strukturës dhe organikës së institucionit.*

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Kontrollit të Cilësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë”, të ushtruar në Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, sipas programit të auditimit nr. 360/2, datë 29.05.2019, për veprimtarinë e institucionit nga data 01.01.2018 deri në 30.05.2019

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi përputhshmërinë (I pakualifikuar)¹

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së ISKPK me rregullat financiare dhe rregulloret për implementimin e tyre, përfshirë rregullat mbi prokurimet, limitet buxhetore, si dhe rregulla, rregullore, marrëveshje që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve të ISKPK.

Mbështetur mbi punën audituese në përfundim rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i ISKPK është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme.

Transaksionet e kryera gjatë ekzekutimit të buxhetit të ISKPK-së kanë qenë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me bazën ligjore dhe rregullative në fuqi, përfshirë rregullat e prokurimeve dhe ato buxhetore.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshiu kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur në materialitetin e vlerësuar, nivelin e parashikuar të riskut si dhe mbi gjykimin profesional dhe të pavarur të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat **për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar të auditimit.**

¹ ISSAI 4000 – Audituesit shprehin opinion të pakualifikuar kur konkludojnë se, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni i reflektuar në pasqyrat financiare janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi,

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i ISKPK^{së} është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

f) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të ISKPK, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME TË LEGJISLACIONIT NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: ISKPK, në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, është “*institucion publik, qendror, i pavarur*”. Referuar nenit 19, pika 2 e po të njëjtit ligj, struktura, organika dhe niveli i pagave të punonjësve të ISKPK, miratohen me VKM.

Nga auditimi rezultoi se, struktura dhe organika e ISKPK si një “*institucion publik, qendror, i pavarur*”, duhet të jetë subjekt miratimi nga Kuvendi, dhe jo nga Këshillin e Ministrave, kjo në përputhje me sa kërkon neni 10 i ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “*Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj*”, ku parashikohet se: “*Struktura dhe organika e institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, miratohen me vendim të Kuvendit, në bazë të numrit të miratuar në zbatim të ligjit vjetor të Buxhetit të Shtetit, për secilin institucion*”.

Nga auditimi rezultoi se me shkresën nr. 565, datë 17.10.2017, ISKPK i ka propozuar për miratim KM, strukturën dhe organikën me disa ndryshime, duke u mbështetur gjithashtu në një sërë rekomandimesh/miratimesh të dhëna nga DAP-i² dhe miratimin përkatës nga Ministra e Financave³. Prej muajit tetor, të vitit 2017 e deri më tani, KM ende nuk ka miratuar strukturën dhe organikën e propozuar të ISKPK, edhe pse nga Kuvendi, këtij

²me shkresat nr. 2692/2 dhe 2692/4 datë 04.05.2017 dhe 15.05.2017

³me shkresat nr. 5673/1 dhe 5763/3, datë 02.05.2017 dhe 16.05.2017.

institucioni ka vijuar t'i miratohet buxhet për fondin e shtuar të pagave, që merr parasysht ndryshimet e mësipërme në organikë dhe strukturë, duke bërë që ky fond çdo vit të "digjet" (konkretisht për vitin 2018 miratuar dhe "djegur" shuma prej rreth **2,924 mijë lekë**; dhe për vitin 2019, miratuar shuma prej **3,800 mijë lekë**).

Sa më sipër jo vetëm që përbën menaxhimin jo efektiv të fondeve për shkaqe jashtë kontrollit menaxherial të ISKPK, po gjithashtu rrezikon realizimin e objektivave të institucionit, në kushtet kur burimet njerëzore janë të paplotësuara.

1.1.Rekomandimi

Në këto kushte rekomandojmë, që ISKPK t'i drejtohet Kuvendit për **shfuqizimin e:**

- pikës 2 të nenit 19 të e Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 "*Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri*" i cili parashikon se: "*Struktura, organika dhe niveli i pagave të punonjësve të institutit miratohen me VKM*"; dhe
- nenit 20 të po të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "*Ngarkohet KM të miratojë strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të nëpunësve e punonjësve të tjerë të Institutit dhe të shpërblimeve brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 12 dhe 19 të këtij ligji*"

Menjëherë

C. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, total shpenzimet e vitit 2018 janë realizuar në masën 27,568 mijë lekë, nga 33,700 mijë lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit buxhetor, pra me një realizim prej 81.8% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 6,132 mijë lekë; Ndërsa për 4 mujorin e parë të vitit 2019, ISKPK ka raportuar se programi buxhetor është realizuar në shumën 7,041 mijë lekë nga 12,400 mijë lekë që ishin planifikuar për të njëjtën periudhë, duke rezultuar në një mosrealizim prej 5,359 mijë lekë (ose realizuar rreth 57% e planit). Në mos-realizimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi vihet re se kanë ndikuar disa faktorë të jashtëm (të pavarur nga ISKPK si psh buxhet i porealizuar i fondit të pagave si pasojë e mosmiratimit të strukturës dhe organikës nga KM) dhe faktorë të brendshëm sic është kujdesi përgjatë procesit të planifikimit.

1.1.Rekomandimi

Me qëllim menaxhimin efektiv të fondeve buxhetore, nevojitet planifikim aktiv, dhe monitorim i kujdesshëm i buxhetit, konkretisht:

- Planifikimi duhet të nisë nga nevojat e secilës drejtori/sector, duke u planifikuar me kujdes, aktivitetet e nevojshme, produktet mbi të cilat këto aktivitete do të ngrihen e zhvillohen, në sasi dhe vlerë, me qëllim garantimin se objektivat respektive të njëjësive dhe si pasojë të vetë institucionit, do të përmbushen në kohën dhe masën e duhur.
- Nevojitet monitorim i kujdesshëm ndaj realizimit të produkteve në përputhje me planet e parashikuara me qëllim ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në llogarinë 312107 "Libra dhe Publikime profesionale" janë kontabilizuar 175 libra (sipas Aneksit 3, bashkëlidhur këtij projekti), me vlerë kontabël 169,450 lekë, të cilat janë blerë nga ISKPK për qëllime studimore dhe si të tilla nuk duhet të jenë pjesë e inventarit qarkullues por e atij të

qëndrueshëm, reflektuar në llogarinë 2120112 “Krijim Fond Biblioteke”. Ndër kriteret e klasifikimit të aktiveve si afatgjata janë: përdorimi i tyre për prodhim mallrash (në rastin e ISKK-së prodhimin e librave studimore të vetë institutit), si dhe përdorimi i tyre për më shumë se një periudhë kontabël.

2.1.Rekomandimi

Të merren masa që të bëhet veprimi korigjues duke evidentuar çregjistrimin e 175 librave, me vlerë kontabël 169,450 lekë nga llogaria 312107 “Libra dhe Publikime Profesionale”, dhe regjistrimi i tyre në llogarinë 2120112 “Krijimi Fond Biblioteke”

Brenda datës 30.09.2019

3. Gjetje nga auditimi: Në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve, në relacionin që shoqëron inventarizimin citohet se, se automjeti i tipit _ Tip Hyundai Terracan me targa TR9286F dhe Nr identifikimi (shasie) KMHNM81XP3U110465, paraqitet me gjendje jo të mirë fizike. Nga auditimi rezultoi se vlera e mbetur e makinës është zero. Nga ana tjetër u konstatua se qysh në PBA 2018-2020, janë planifikuar fonde për blerjen e një automjeti të ri, në kushtet kur ai ekzistuesi është thuhetse i amortizuar (blerë në vitin 2011) dhe shpenzimet e mirëmbajtjes për të janë relativisht të larta (rreth 10% e total llogarisë 602 “Mallra dhe shërbime”). Duke u mbështetur në këto nevoja dhe argumentime, ISKPK ka blerë automjetin e ri në vitin 2018, ndërkohë që ende mban në pronësi automjetin e vjetër.

3.1.Rekomandimi

Nëpunësi Autorizues (NA) të marr masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të automjetit, me qëllim që mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, të bëhet vlerësimi i tij. Në përfundim të procesit, komisioni i vlerësimit duhet të argumentojë nëse aktivi është/nuk është më i nevojshëm për veprimtarinë e njësisë dhe mundësitë potenciale për përdorimin e tij nga njësi të tjera, apo tjetër. Në varësi të konkluzionit të komisionit të vlerësimit, NA duhet të marr masa për ngritjen e komisionit për nxjerrjet jashtë përdorimit/ose tjetërsimin e aktivitetit, me qëllim: ose transferimin pa pagese të tij në një njësi tjetër publike (konfirmimi zyrtar nga njësi përfituese vërteton përfundimin e transaksionit); ose shitjen e automjetit në ankand.

Brenda datës 30.09.2019

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISKPK nuk ka një Regjistër të Aktiveve sipas kërkesave që dikton Udhëzimi nr. 30, date 27.12.2011, i cili të përmbajë minimalisht datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësi.

4.1.Rekomandimi

Nëpunësi Zbatues (NZ) të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me qëllim zbatimin e disiplinës financiare për përputhshmërinë e llogarive sintetike me ato analitike (në rastin konkret, regjistrin e aktiveve)

Brenda dates 30.09.2019

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive: 2120112 ” Fond Biblioteke”; 2187 “Të tjera pajisje zyre” ;dhe 2181”Mobilje zyre”, gjatë vlerësimit të përlllogaritjes së amortizimit të aktiveve në këto llogari, u konstatua se, janë aplikuar norma amortizimi kundrejt objekteve: piktura, emblemë bronxi dhe libra, ndërkohë që mbështetur mbi Standardet e Kontabilitetit (SKK 5) nuk duhet të aplikohet amortizim mbi veprat e artit dhe librat konkretisht mbi:

- Librat, të cilët paraqiten me amortizim kumulativ deri më datë 31.12.2018 në shumën

36,953 lekë (norma e aplikuar 5%) (Aneksi 5)

- 4 piktura, me amortizim kumulativ deri më datë 31.12.2018 në shumën **180,843 lekë** (norma e aplikuar 20%)(Aneksi 6)

- Emblemën e ISKPK me kosto historike 228,420 lekë (skulpturë bronxi me diametër 0.6 m) me amortizimi kumulativ deri më datë 31.12.2018 në shumën **181,646 lekë** (norma e aplikuar 20%) (Aneksi 1);

Konkludojmë se librat, dhe veprat e artit, nuk janë objekt amortizimi, pasi kanë një jetë të dobishme pa afat, referuar Standardit të kontabilitetit SKK 5 / Paragrafi 29 ku parashikohet se *“Vlera e amortizueshme e një elementi të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përrjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.”*

5.1.Rekomandimi

Nëpunësi Zbatues (NZ) të marrë masa që në vijim të mos përlllogarisë amortizim për këtë kategori aktiveve si dhe të kryejë veprimet korrigjuese për amortizimin e përlllogaritur deri tani si vijon:

- për amortizimin e librave, fond i bibliotekës së ISKPK, për shumën prej **36,953 lekë**, të debitorjve llogarinë e AAGJ - 2120112 dhe kreditorjve llogarinë “Shtesa e Fondit Bazë” -1011;

- për amortizimin e 4 pikturave, për shumën prej **180,843 lekë** të debitorjve llogarinë “Të tjera pajisje zyre” - 2187 dhe kreditorjve llogarinë “Shtesa e Fondit Bazë” - 1011 ;

- për amortizimin e emblemës së ISKPK, për shumën prej **181,646 lekë** të debitorjve llogarinë “Mobilje zyre” - 2181dhe kreditorjve llogarinë “Shtesa e Fondit Bazë” -1011.

Brenda datës 30.09.2019

6. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje automjeti për nevojat e ISKPK –së”, të realizuar në muajin mars të vitit 2019, me fond limit në vlerën 1.666.667 (një milion e gjashtëqindmijë e gjashtë qind gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe fitues OE “L..” sh.p.k, me vlerë kontrate 1,580,0000 Lekë, pa TVSH (dhe 1,896,000 lekë me TVSH), është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi Njësia e Prokurimit dhe KVO, për mungesë të kapaciteteve njerëzore, nuk kanë pasur në përbërje ekspertë të fushës për objektin e këtij prokurimi (inxhinier mekanik). Gjithashtu rezultoi se, gjatë fazës së hartimit dhe përgatitjes së dokumentave të tenderit është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik pasi:

- Në dosje nuk ka një procesverbal të hartimit të dokumentacionit standard të tenderit;

- DT janë firmosur vetëm nga dy anëtarët e njësisë së prokurimit dhe nuk janë firmosur nga personi përgjegjës D.M, jurist i kësaj njësie.

6.1.Rekomandimi

Në të gjitha procedurat e prokurimit që do të kryhen në të ardhmen, Njësia e Prokurimit të marra masa që të hartojë dhe miratojë Dokumentat të Tenderit, në përputhje me Dokumentat Standarde të Tenderit për kontratat e furnizimeve (mallrave).

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël të AK-së, me objekt: *“Realizimi i programit video-dokumentar për muzeun virtual të Tepelenës”*, dhe Fond limit 480.000 (katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, dhe 576.000 (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë me TVSH, konstatohet, se procedurat për këtë shërbim kanë ndjekur rregullat e prokurimit publik në një kohë kur si shërbim specifik AK duhet të mbështetej në VKM nr.1195, datë 05.08.2008 *“Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për trasmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në mediat e shkruar, dhe për kontratat, për kohë trasmetimi, nga organet e administratës shtetërore”*, i hartuar në bazë të nenit 7, germa *“b”* e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*. Në LPP, ky neni (neni 7 *“Përjashtimet e vecanta”*) ndër të tjera parashikon se, ky ligj nuk zbatohet në kontratat e shërbimit publik për:

- a. blerjen ose qiranë me çdo mjet financiar të pasurive të paluajtshme apo të drejtave mbi to. Bëjnë përjashtim kontratat për shërbime financiare, të lidhura në atë çast, para ose pas kontratës së blerjes ose të qerasë së çdo forme, të cilat I nënshtrohen këtij ligji;
- b. blerjen, zhvillimin, prodhimin, bashkëprodhimin e programeve ose të reklamave për trasmetimin nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat për kohë trasmetimi, etj. Rastet përjashtimore sipas shkronjave *“a”* deri në *“e”* të këtij neni, rregullohen me akte të tjera ligjore ose nënligjore.

7.1.Rekomandimi

Për të gjitha rastet e shërbimeve të kësaj natyre, që lidhen me blerjen, zhvillimin, prodhimin, bashkëprodhimin e programeve ose të reklamave, ISKPK të procedojë në zbatim të VKM nr.1195, datë 05.08.2008 *“Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve të reklamave për trasmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në mediat e shkruar, dhe për kontratat, për kohë trasmetimi, nga organet e administratës shtetërore”*, dhe jo në zbatim të ligjit për prokurimin Publik dhe akteve të dala në zbatim të tij

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme, rezultoi se:

- a. ISKPK nuk ka një program specifike për trajnimin e punonjësve të administratës,
- b. Nuk është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut, e cila të jetë përditësuar çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Strategjia për menaxhimin e riskut përcakton mënyrën se si sillet organizata ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.
- c. Nuk janë miratuar regjistrat e risqeve, duke rrezikuar që planet vjetore të punës të (mos) lidhen me planin strategjik të njësisë publike, me qëllim që lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor të shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike
- d. Si pasojë e sa më sipër GMS nuk ka përgatitur një raport vjetor me qëllim kontrollin se si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike.
- e. Nga auditimi rezultoi se për vitin 2018, janë bërë vetëm vlerësimet vjetore të performancës për punonjësit e ISKPK-së, por jo gjashtë-mujoret sikundër e kërkon VKM nr. 109, datë 26.2.2014 *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*.

8.1.Rekomandimi

a. Titullari i ISKPK-së të marrë masa për miratimin e programeve specifike për trajnimin e punonjësve

Brenda datës 30.06.20219

b. Titullari i njësisë publike të marrë masa për hartimin e Strategjisë së Riskut të ISKPK-së, me qëllim mirë funksionimin e kontrolleve të brendshme. Të ngrihen grupet e punës për miratimin e regjistrave të riskut.

Brenda datës 30.08.2019

c. Në çdo rast, GMS të marrë masa për të përgatitur një raport vjetor me qëllim kontrollin se si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike.

Në vazhdim

d. Të merren masat që të plotësohen vlerësimet për 6 mujorin e vitit 2019 sipas të gjithë proceseve që dikton ligji baza ligjore në fuqi

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bordi Drejtues i ISKPK-së nuk ka miratuar procedurat e marrjes në punë të punonjësve të rinj, në kundërshtim me Paragrafi 10 / Kreu III “Funksioni dhe detyra e Bordit të ISKPK” të Rregullores së Brendshme të ISKPK.

9.1.Rekomandimi

Nga sa më sipër nevojitet që Bordi të marrë masat që të miratojë procedurat e marrjes në punë të punonjësve të rinj, ku ndër të tjera të përfshijë:

- Miratimin e Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, sipas nevojës;

- Krijimin e Komitetit të Përhershëm të Pranimit;

- Përcaktimin e qartë të procedurave të rekrutimit në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, ku të parashikohen qartë fazat nëpër të cilat do të zhvillohet rekrutimi.

-Të bëhet shpallja e procedurës së pranimit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në stendat e informimit të publikut, si dhe në faqen e internetit.

- Shpallja e procedurës së pranimit të botohet të paktën 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit;

-Shpallja në faqen zyrtare të DAP-it apo të vetë institucionit të përmbajë të dhënat që kërkon ligjit nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Procedurat e rekrutimit të miratuara nga Bordi, të bëhen pjesë e Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Institutit.

Brenda datë 30.08.2019

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se procesi i qarkullimit të shkresave brenda institucionit edhe pse hartuar shumë mirë sipas Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e ISKPK”, paragrafi 1.7.7 nuk implementohet në çdo rast, duke mbartur risqe të funksionimit të kontrolleve të brendshme që lidhen me mostrajtimin në kohë të çështjes, ose mungesës së gjurmimit të personave përgjegjës për realizimin e një detyre/çështjeje të caktuar.

10.1.Rekomandimi

Rekomandojmë që, në përputhje me kërkesat e Rregullores së Brendshme “Për organizimin

dhe funksionimin e ISKPK”, korrespondenca e protokolluar, pasi t’i bashkëlidhet me kartelën shoqëruese, t’i përcillet Titullarit, për dhënien e udhëzimeve mbi trajtimin e secilës praktikë. Edhe në rastet kur një shkresë nuk i drejtohet Titullarit, korrespondenca duhet të ndjek po të njëjtën rrugë administrative. Sipas shënimeve për mënyrën e trajtimit, të bëra nga titullari, korrespondenca t’u dërgohet funksionarëve të caktuar për ndjekjen e tyre, nëpërmjet sekretarisë.

Në vijimësi

D. TË TJERA

Gjatë periudhës së këtij auditimi të ushtruar në ISKPK, Kontrolli i Lartë i Shtetit nëpërmjet medias së shkruar dhe vizive si dhe nga hulumtimit i faqes zyrtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, është njohur me propozimin e një projekt ligjin për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10242, datë 25.02.2010 “*Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në RSH*”. Këto propozime, në thelb konsistojnë në ndryshimin e nenit 18 të këtij ligji, për pajisjen e nëpunësive e ISKPK-së me certifikatë sigurie si dhe të rekrutimit në punë në këtë institucion të punonjësve të cilët duhet të kenë mbushur moshë madhore përpara datës 08.12.1990.

Nisur nga sensibiliteti dhe nga impakti i gjerë publik që mbart kjo çështje, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të Neni 17, pika 3, e Ligjit nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së*”⁴ shqyrtoi dhe analizoi këto ndryshime ligjore dhe në përfundim doli me opinionin se:

-Pajisja e punonjësve të këtij institucioni me certifikatën e sigurisë nuk është relevante dhe as e domosdoshme në ushtrimin e detyrës;

-Rekrutimit i punonjësve që të kenë mbushur moshë 18 vjeç përpara datës 08.12.1990, çënon të drejtën kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të konkurruar në kushte të barabarta punësimi.

Për këto arsye, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresë nr.536, datë 22.07.2019 i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke argumentuar, si më poshtë:

Në projektligjin e ri është propozuar ndryshimi i nenit nr. 18 të Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 “*Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit*” në të cilin parashikohet se: “*Nëpunësit dhe punonjësit e institutit e të arkivit duhet të jenë persona që gëzojnë besueshmëri. Për qëllimet e këtij ligji, i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore përpara datës 8 dhjetor 1990, është pajisur me Certifikatë të Sigurimit të Personelit nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar*”.

Duke qenë se nëpunësit e këtij instituti rekrutohen duke u bazuar në Ligjin për Nëpunësin Civil, ndryshimet e sipërcituara, që janë pjesë e projektligjit të propozuar bien ndesh me nenin 20 të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*” të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se “*Pranimi në shërbimin civil bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë*”.

Vendosja e kriterit që “*i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore përpara datës 8 dhjetor 1990*” përjashton në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe haptazi nga rekrutimi dhe për rrjedhojë nga kryerja e kërkimeve shkencore historike të gjithë shtetasit

⁴ Neni 17, pika 3, e Ligjit nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së*”, i njeh KLSH-së tagrin e dhënies së opinioneve si dhe bërjen e propozimeve për sa i përket përmirësimit të legjislacionit në fushat brenda kompetencave të tij.

shqiptarë që nuk kanë qenë në moshë madhore në datën 8 dhjetor 1990. Kjo çënon të drejtën e një grupi shtetasish shqiptarë për të konkurruar në kushte të barabarta dhe për të gëzuar statusin e nëpunësit civil në këtë institucion.

Projektligji në formën e propozuar çënon të drejtën e të gjithë atyre shtetasve shqiptarë të cilët kanë lindur pas vendosjes së sistemit demokratik në Shqipëri dhe nuk janë indoktrinuara nga studimi në sistemin para-universitar dhe universitar i historisë së sistemit komunist.

Gjithashtu, në nenin 18 të ligjit të sipërcituar parashikohet që, për efekt të të qenit “*i besueshëm*” punonjësit e institutit duhet të pajiset me certifikatë sigurie nga DISK, duke bërë të detyrueshëm pajisjen e të gjithë punonjësve me këtë dokument.

Dokumentet që studiuesit e këtij instituti përdorin janë kryesisht dokumente të cilat sigurohen nga institucioni i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, i cili bazon veprimtarinë e tij në Ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Kërkesat për vënien në dispozicion të dosjeve ose materialeve të tjera trajtohet duke u bazuar në nenin 26 të ligjit të sipërcituar, në të cilën përcaktohet se “*Autoriteti, përpara përgjigjes, kontrollon nëse kërkesa për njoftim, shqyrtim apo dorëzim dokumentesh:*

- *përmban një qëllim të lejueshëm përdorimi;*
- *është në kuadrin e detyrave të kërkuarit dhe deri në çfarë mase;*
- *përdorimi është i domosdoshëm për qëllimin e deklaruar”.*

Informimi për qëllime kërkimore dhe historike rregullohet gjithashtu nga neni 36 i Ligjit nr. 45/2015, i cili përcakton qartazi llojet e dokumenteve që vihen në dispozicion për qëllime studimi, duke përcaktuar gjithashtu edhe kufizimet.

Me qëllim aksesin më të gjerë të të interesuarve në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ky institucion bën vazhdimisht deklasifikimin e dokumenteve, ku mund të përmendet se vetëm në vitin 2018 janë deklasifikuar 33,700 fletë dokumente arkivore, ndërsa për gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 janë deklasifikuar 37,626 fletë dokumente⁵.

Duke parë trendin në rritje të numrit të dokumenteve të deklasifikuara nga Autoriteti i Dosjeve dhe duke pasur parasysh, që hartimi i një dokumenti studimor mbi një ngjarje të caktuar historike kërkon kohë dhe shqyrtim të shumë dokumenteve, si dhe marrjen e dëshmimeve edhe nga persona të cilët kanë qenë të përfshirë direkt ose indirekt në këto ngjarje, pajisja e të gjithë nëpunësve të Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit me certifikatë sigurie shkon në drejtim të kundërt me këtë trend.

Ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, neni 17, pika 5 përcakton se: “*E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar. Autoriteti publik njofton menjëherë kërkuarin për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit, sipas ligjit, dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në çdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të kriterëve të këtij neni”.*

Për rastet kur studiues / punonjës të ISKPK kërkojnë akses në dokumente të klasifikuara “sekret” ose “top sekret” gjejnë zbatim përcaktimet e VKM nr. 312, datë 16.03.2011 “Për miratimin e rregullores për punën me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” në të cilin përcaktohet se “*pranë çdo ministrie apo institucioni shtetëror, i cili administron*

⁵ *Informacion i marrë nga faqja e internetit e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.*

informacion të klasifikuar “sekret shtetëror” funksionon Zyra e Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”. Zyra e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” mund të regjistrojë, qarkullojë, administrojë, shumëfishojë, arkivojë edhe informacion të paklasifikuar, por në regjistra të veçantë për informacionin e paklasifikuar... Zyra e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, që ndodhet në ministri ose institucione shtetërore, përfshirë strukturat e tyre përbërëse, ndodhet në varësi të titullarit ose strukturës përkatëse, të cilët janë dhe përgjegjës për funksionimin e saj. Shpërndarja për shfrytëzimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, bëhet me miratim të titullarit, vetëm tek ata punonjës, të cilët janë pajisur me “certifikatë sigurie” të përshtatshme dhe në bazë të parimit “nevojë për njohje”.

Në këto kushte vlerësojmë se, kriteri për pajisjen e punonjësve të këtij institucioni me certifikatën e sigurisë nuk është relevant dhe as i domosdoshëm në ushtrimin e detyrës së tyre për kryerjen e studimeve të krimeve të komunizmit.

Ngritja e Zyrës për Informacionin e Klasifikuar në këtë Institucion është e mjaftueshme dhe në përputhje me gjithë legjislacionin për administrimin dhe përdorimin e informacionit të klasifikuar.

Duhet theksuar se, në krijimin e këtij institucioni dhe përzgjedhjen e drejtuesit të tij nga Kuvendi, Ligjvënësi ka synuar dhënien e mbështetjes nga të gjitha forcat politike për studimin e historisë së një periudhe të errët të historisë së Shqipërisë, e cila ka në favor marrjen e dëshmive jo vetëm duke u bazuar në dokumente, por edhe në dëshmi të të mbijetuarve dhe të vuajtësve të regjimit komunist.

Vendosja e kriterëve kufizuesë në projektligjin e propozuar të cituara do të çonin në mënyrë të pashmangshme në cungimin dhe fragmentarizmin e kryerjes së studimeve historike dhe zbardhjen në mënyrë të paanshme e të plotë të ngjarjeve dhe krimeve të komunizmit dhe mosplotësimin e misionit për të cilin është krijuar ky institucion, duke vënë në diskutim, në mënyrë të drejtpërdrejtë përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit që vihen në dispozicion të këtij institucioni çdo vit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

K R Y E T A R I

Bujar LESKAJ